



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më: 20 prill 2010
Ref. Nr.: RK 12 /10

VENDIM PËR PAPRANUESHMERI

Rasti nr. KI 05/09,

Ahmet Ismail Rexhepi
kundër
Policia e Kosovës dhe
Zyra e Prokurorit Publik Komunal të Prishtinës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese në përbërje:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendës Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtare
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës, Ahmet Ismail Rexhepi, me banim në Prishtinë.

Pala kundërshtare

2. Palët kundërshtare janë Policia e Kosovës dhe Zyra e prokurorit publik komunal të Kosovës.

Lënda

3. Parashtruesi ankohet se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 27 të Kushtetutës (Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues). Parashtruesi pretendon se ka pasur mungesë të veprimeve adekuate nga ana e Policisë së Kosovës dhe Zyrës së prokurorit publik komunal të Prishtinës në gjetjen dhe ndjekjen penale të personave që sulmuan dhe rrahën djalin e tij më 30 tetor 2006. Sipas raporteve mjekësore, në atë kohë, djali i tij, i lindur më 11 nëntor 1991, ishte ende i mitur.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Kushtetuta); neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Ligji), dhe neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Rregullorja e punës).

Përmbledhje e procedurës

5. Parashtruesi i ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 24 shkurt 2009. Më 27 shkurt 2009, Parashtruesi u informua nga Sekretariati i përkohshëm i Gjykatës Kushtetuese se rasti i tij do të shqyrtohet pasi që Gjykata të bëhet tërësisht funksionale.

6. Më 23 dhjetor 2009 Gjyqtari Raportues komunikoi rasti palëve kundërshtare. Ato ofruan përgjigjet e tyre para Gjykatës një ditë pas komunikimit.

7. Më 18 shkurt 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit Raportues, Kadri Kryeziu, Kolegji Shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve Ivan Čukalović (Kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami, rekomandoi para Gjykatës në përbërje të plotë që rasti të refuzohet si i papranueshëm.

Faktet

8. Nga dokumentet e dorëzuara nga Parashtruesi shihet se më 30 tetor 2006, disa individë (të cilët sipas pohimeve të parashtruesit janë të njohur për policinë) rrahën të birin e mitur të Parashtruesit. Sipas kopjeve të raporteve mjekësore, i biri i Parashtruesit pësoi, mes tjerash, *Cefalea* (d.m.th. në gjuhën shqipe dhimbje koke) dhe *Stres ulcus vomitus*.

9. Një ditë pas sulmit, Parashtruesi bashkë me të birin e tij shkuan në polici për t'i dhënë atyre informata shtesë mbi rastin. Megjithatë, Parashtruesi nuk pranoi informata të më tutjeshme.

10. Më 13 nëntor 2006 Parashtruesi parashtroi ankesë në Zyrën e Avokatit të Popullit në Kosovë. Zyra e Avokatit të Popullit komunikoi rastin para Zëvendës Komisionerit të Policisë më 2 prill 2007.

11. Parashtruesi pohon se deri kohëve të fundit ai ka vizituar stacionin policor së paku 9 herë, Zyrën e Prokurorit publik së paku 3 herë por, thekson ai, pa sukses. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në policinë e EULEX-it dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

12. Megjithatë, duket se deri tani policia nuk i ka identifikuar personat që kanë sulmuar të birin e Parashtruesit dhe si rrjedhojë askush nuk është dënuar për këtë vepër.

Pohimet e Parashtruesit

13. Parashtruesi ankohet se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 27 të Kushtetutës (Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues)

Komentet e palëve kundërshtare

14. Më 24 dhjetor 2009 the Prokurori publik komunal ofroi përgjigjet për Gjykatën Kushtetuese. Sipas Prokurorit, ata kanë pasur komunikime të disahershme mbi këtë rast (më 8 maj 2005, 5 shkurt 2008, dhe 18 mars 2009) me Policinë. Prokurori publik më tutje pohon se për t'i gjetur individët të cilët sulmuan të birin e Parashtruesit ata kanë marrë deklarata nga një dëshmitar të identifikuar nga Parashtruesi. Megjithatë, ky dëshmitar nuk arriti t'i identifikojë personat që sulmuan të birin e Parashtruesit.

15. Veç kësaj, në përgjigjen e tij për Gjykatën, Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës thekson se policia i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetuese dhe ka intervistuar viktimën dhe dëshmitarët. Megjithatë, Policia nuk kishte dëshmi dhe fakte të mjaftueshme për të identifikuar të dyshimtit. Si rrjedhojë, më 27 prill 2007, ky rast iu dërgua Prokurorit publik si rast kundër "kryerësve të panjohur".

Vlerësimi i pranueshmerisë së Kërkesës

16. Për të gjykuar për Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse Parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kërkesat për pranueshmeri, të përcaktuara në Kushtetutë.

17. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet që:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo

vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”;

dhe nenit 47.2 të Ligjit, ku përcaktohet që:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

18. Siç është theksuar në lëndën nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës (Vendimi nr. RK-04/10 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, datë 27 janar 2010), Gjykata dëshiron të theksojë se mendimit prapa rregullit të shterimit të mjeteve juridike, sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih nenin 53 të Kushtetutës), është që t’iu ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatave, mundësinë për të parandaluar apo përmirësuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimit se rendi ligjor i Kosovës do të ofrojë mjete efektive juridike për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni v. Francë, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngriten në procedurat në fjalë. Përderisa çështja është ngritur në mënyrë të nënkuptuar apo në substancë, shterimi i mjeteve juridike është përmbushur (shih, mutatis mutandis, EGJDNJ, Azinas v. Qipro, nr. 56679/00, vendimi i 28 prillit 2004).

19. Nga pohimet e Parashtruesit dhe nga përgjigjet e Palëve kundërshtare duket se rasti i Parashtruesit është ende i pazgjidhur.

20. Edhe duke supozuar se Gjykata do të shtrijë autoritetin e saj për të shqyrtuar Kërkesën e parashtruesit në teorinë se Parashtruesi i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, duket se Kërkesa duhet të refuzohet për shkak të arsyeve në vijim.

21. Duke marrë parasysh pohimet e cekura në Kërkesë, çështja mund të ngritet nëse vuajtja e shkaktuar ndaj Parashtruesit mund të konsiderohet si torturë, trajtim apo ndëshkim mizor, çnjerëzor dhe degradues për arsye se nuk është bërë asnjë përparim në hetimin në fjalë 4 vite pas sulmit ndaj të birit të Parashtruesit.

22. Gjykata thekson se neni 27 i Kushtetutës është identik me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku thuhet:

“Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.”

23. Është përcaktuar mirë se neni 3 i Konventës Evropiane ngërthen një nga vlerat më thelbësore të një shoqërie demokratike. Kjo nënkupton një nga “të

drejtat absolute" të Konventës Evropiane dhe shtetet nuk mund t'i shmangen pajtueshmërisë me të madje as në kohë lufte.

24. Duke marrë parasysh përgjigjet e Palëve Kundërshtare, Gjykata Kushtetuese është e mendimit se autoritetet kanë ndërmarrë angazhimet e tyre më të mira dhe i kanë ndjekur procedurat relevante për të përcaktuar identitetin e kryerësve dhe për t'i sjellë ata para drejtësisë.

26. Për më tepër, Parashtruesi, si babai i të miturit, në atë kohë, i cili ishte viktimë e sulmit, nuk ka paraqitur dëshmi *prima facie* që do të tregonin shkelje të kësaj të drejte sipas nenit 27 të Kushtetutës dhe nenit 3 të Konventës Evropiane (shih Vanek v. Republika Sllovake, Vendimi mbi pranueshmerinë e Kërkesës nr. 53363/99 datë 31 maj 2005). Prandaj, kjo ankesë nuk është bazuar dhe duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit, si dhe nenit 55 të Rregullores së Punës, njëzëri,

VENDOS



I. PËR TË REFUZUAR Kërkesën si të papranueshme.

II. Ky vendim do t'u komunikohet të gjitha Palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Mr.Sc.Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

